

We



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 07.06.2021

**KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE
(KABK)
2022 – 2024**

1. Qëllimi

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2022-2024 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2022. Qëllimi kryesor i KABK-së është që të ofrojë një analizë të bazuar të mjedisit makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Kjo kornizë e buxhetit për vitet 2022-2024 bazohet në KASH 2022-2024 që është aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Korniza është hartuar në bazë të Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020, Qarkores Buxhetore 2022/01 të lëshuar nga MFPT, Qarkores së Brendshme Buxhetore Komunale 2022/01, LMFP të nenit 20 etj. Komuna (DBF) ka për detyrë ta dorëzojë këtë kornizë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, të aprovuar nga Kuvendi Komunal, deri më 30 qershor të vitit aktual.

2. Objektivat e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale

Korniza Afatmesme Buxhetore për periudhën 2022–2024 planifikohet në bazë të Buxhetit, i cili bazohet në “Buxhetin e programeve” dhe është i bazuar në objektivat e Komunës. KAB Komunale 2022–2024 është krijuar në përputhje me udhëzimet e Qarkores Buxhetore nr. 2022/01, e cila sfond të vetin dhe kontekst ka prioritetet e programeve dhe kursimet e shpenzimeve.

Objektivat e Komunës:

- Mbrojtja, përmirësimi i ambientit dhe infrastrukturës së qytetit;
- Përfshirja e tërësishme në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e nivelit të arsimit;
- Zhvillimi i fushës së shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
- Zhvillimi i fushës së kulturës, rinisë dhe sportit;
- Promovimi dhe përkrahja e bizneseve të vogla dhe të mesme;
- Përkrahja e të rinjve dhe ulja e papunësisë;
- Subvencionimet në bujqësi;
- Përkrahja e OJQ-ve në përgjithësi, e në veçanti organizatat e të rinjve.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesës së Qeverisë për përgatitjen e buxhetit në kohën e duhur, thelbësore është që të gjitha drejtoritë të veprojnë në pajtim me afatet kohore dhe kërkesat e specifikuar në këtë Kornizë. KAB Komunale paraqet një mjet të procesit për zhvillimin e buxhetit, që bën ndërlidhjen e planeve, politikave dhe resurseve në dispozicion me prioritetet e komunës, me qëllim që të demonstrojë qëndrueshmërinë e programeve komunale gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare, si dhe projekteve të cilat ndihmojnë në realizimin e prioriteteve të Qeverisë, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. KAB duhet të përcaktojë këto fusha përkatëse për tri vitet vijuese fiskale:

- Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2020-2024 (mil. euro);
- Vlerësimin e të hyrave nga të gjitha burimet;
- Vlerësimet e hershme (nëpër kategoritë ekonomike);
- Programi i investimeve publike.

Në KAB janë paraqitur tabelat që prezantojnë shpërndarjen e grantit, projeksionin e të hyrave të drejtorive nga të gjitha burimet, investimet kapitale, ndarja e buxhetit sipas programeve dhe nënprogrameve, si dhe masat dhe rekomandimet tjera, etj.

Tabela 1: Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2020-2024 (mil. Euro)

Përshkrimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
1. Grantet qeveritare	463.5	439.99	457.62	479.39	503.10
1.1 Granti i përgjithshëm	196.3	182.58	193.53	202.09	211.80
Granti i përgjithshëm	196.3	182.58	193.53	202.09	211.80
Kontigjenca për korrektim të formulës	0	0	0	0	0
1.2 Granti specifik për shëndetësi	61.7	62.6	62.6	65.7	69.1
1.3 Granti specifik për arsim	205.6	194.81	201.5	211.6	222.2
2. Financimi për shëndetësi sekondare	2.6	2.6	2.6	2.6	2.6
3. Shërbimet rezidenciale	2	0.069	2.3	3.1	3.9
4. Financimi për QHP, QKHFZ dhe KHM	0.1	0.1	0.07	0.07	0.07
5. Granti për Kryeqytetin- Prishtinën	11.8	11.0	11.6	12.1	12.7
6. Financimi për Obiliqin	4.2	4.6	5.0	5.0	5.0
7. Të hyrat vetanake komunale	83.1	78	87.4	92.5	96.5
8. Financimi për teatro	0.9	0.9	0.9	0.9	0.9
9. Financimi nga huamarrja	0	0	0	0	0
10. Klauzola e investimeve	11.5	7.4	0	0	0
Total financimi Komunal	579.74	546.80	567.5	595.7	624.8

3. Shpërndarja e granteve

Në tabelat e poshtëcekura (2) kemi të dhënat e shpërndarjes së granteve për komunën tonë, të aprovuara nga Komisioni i Granteve që është mbajtur në muajin prill të këtij viti, nga Qarkorja Buxhetore 2022/1, nr. pr.797 të datës 14.05.2021, të lëshuar nga MFPT-ja.

- **Granti i përgjithshëm** për komuna për vitin 2022 është aprovuar nga Komisioni i Granteve në shumë prej 193.53 milion euro.

Kjo ndarje bazohet në formulën e përcaktuar në nenin 24 të LFPL-së. Sipas këtij neni 10% e të hyrave totale të buxhetuara të Qeverisë u ndahen komunave. Me qëllim të nivelimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, bazuar në LFPL, secila komunë do të pranojë për çdo vit një shumë të përgjithshme fikse prej 140,000 euro, duke zbritur nga 1 euro për kokë banori ose 0 euro për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000 banorë. Pas kësaj, shpërndarja e bërë nëpër komuna bazohet në formulën për alokimin e grantit të përgjithshëm në komuna sipas LFPL: (i) numri i popullsisë llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); (ii) përmasat gjeografike të komunës me gjashtë përqind (6%); (iii) numri i popullsisë pakicë në komunë me tre përqind (3%); (iv) komunat ku shumica e popullsisë të së cilave përbëhet nga pakicat me dy përqind (2%).

- **Granti Specifik për Arsim sipas LFPL**, për vitin 2022 është aprovuar në shumë prej 201.5 milion euro, nga të cilat 181.3 milion euro janë paga dhe mëditje, 17.8 milion euro janë mallra dhe shërbime dhe 2.4 milion euro shpenzime kapitale. Granti Specifik për Arsim sipas LFPL, bazohet në sistem të hapur të financimit, duke marrë parasysh kriteret në formulën e arsimit parauniversitar të MASHT për vitin 2021.

Formula trajton nivelin e arsimit parafillor, fillor dhe të mesëm, duke marrë për bazë këto kriteret:

- a) Numri i nxënësve të regjistruar për vitin 2020/2021;
- b) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit shumicë
1:21.3 (bazuar në Udhëzimin administrativ nr.22/2013 të MASHT);
- c) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin fillor dhe të mesëm për nxënësit pakicë
1:14.2;
- d) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin parashkollor 1:12;
- e) Raporti nxënës-mësimdhënës për arsimin e mesëm profesional për nxënësit shumicë
1:17.2, dhe për nxënësit pakicë 1:11.5;
- f) Raporti nxënës-mësimdhënës për zonat malore 1:14.2;
- g) Kalkulimi për stafin mësimdhënës të gjuhës angleze për klasën I dhe II;
- h) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 630 nxënës 1 staf në arsimin parafillor dhe fillor;
- i) Kalkulimi për stafin teknik administrativ për 470 nxënës 1 staf në arsimin e mesëm;
- j) Kalkulimi për stafin mësimdhënës në lehonitë është paraparë 3% (bazë stafi mësimdhënës);

- k) Kalkulimi për stafin ndihmës për 170 nxënës 1 staf (pastrues) si dhe 1 staf për shkollë (roje);
- l) Shërbimi profesional;
- m) Koordinatorët e cilësisë;
- n) Kalkulimi i pagave është bazuar në Ligjin e Pagave;
- o) Mallrat dhe shërbimet janë kalkuluar sipas kriterit për nxënës (23 euro për nxënës shumicë dhe 25 euro për nxënës pakicë) dhe për shkollë (1,500 euro për shkollë parafillore dhe fillore dhe 3,250 euro për shkollë të mesme);
- p) Kapitalet janë kalkuluar sipas kriterit 7 euro për nxënës;
- q) Kalkulimi i tri pagave pas pensionimit me kosto prej 1.5 milion euro;
- r) Asistent për fëmijë me nevoja të veçanta me kosto prej 0.78 milion euro;

Sipas MASHT-it është raportuar numri për 11 083 nxënës më pak në arsimin parauniversitar krahasuar me vitin paraprak. Duke u bazuar në zvogëlimin e vazhdueshëm të numrit të nxënësve nga viti në vit, dhe duke marrë për bazë parametrat mësimdhënës/nxënës sipas gjendjes aktuale, MASHT-i kërkon nga komunat që me rastin e pensionimit të stafit mësimdhënës mos të shpallin konkurs për pranimin e kuadrit të ri, por të sistemojnë mësimdhënësit të cilët nuk kanë normë ose nuk kanë normë të plotë.

- **Granti i shëndetësisë** - Granti specifik për shëndetësi bazohet në sistem të hapur në përputhje me LFPL. Granti specifik për shëndetësinë primare për vitin 2022 është aprovuar nga KG-ja në shumë prej 62.6 milion euro.

Granti specifik për shëndetësinë primare - granti bazë për vitin 2021 është në shumë prej 62.6 milion euro dhe është përgatitur sipas kriterit për kokë banori (35 €) dhe në pajtim me rekomandimet e Komisionet të Granteve të dala nga raporti vjetor mbi Vlerësimin e Përshtatshmërisë së Sistemit të Financimit Komunal.

Politikë e re, e aprovuar nga KG-ja për vitin 2021, janë vizitat e kujdesit paliativ (vizitë x 20 €) me kosto prej 0.9 milion euro.

Tabela 2. Shpërndarja e Granteve dhe të Hyrave Komunale 2021-2024

Organizata buxhetore	Buxheti	Plani i buxhetit për vitet		
	2021	2022	2023	2024
Granti i Përgjithëshem	3,527,425.00	3,736,842.00	3,900,550.00	4,086,251.00
Granti i Arsimit	3,524,120.00	3,746,942.00	3,934,289.00	4,131,004.00
Granti i Shëndetësisë	1,251,487.00	1,251,487.00	1,314,061.00	1,379,764.00
Të Hyrat Vetanake	2,689,654.00	2,920,809.00	3,027,583.00	3,151,620.00
Huamarrja në Shëndetësi		-		
TOTALI	10,992,686.00	11,656,080.00	12,176,483.00	12,748,639.00

4. Projektionet e të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2022 dhe parashikimet 2023-2024

Projektionet e të hyrave vetanake komunale në shkallë vendi, për vitin 2022, bazuar në vlerësimet makro-fiskale janë në shumë prej 87.4 milion euro. Këto të hyra i shtohen financimit komunal krahas granteve komunale. Të hyrat komunale të komunës sonë realizohen në bazë të “Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale”, “Rregullores për Tatimin në Pronë” si dhe dispozitave tjera ligjore (Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, nr. 03-L-049), të cilat përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave komunale, me të cilat komuna ka të drejtë të caktojë dhe inkasojë të hyrat komunale:

Tabela 3. Parashikimi i të hyrave buxhetore komunale 2022-2024

Burimet e të Hyrave	Buxheti projektionet		
	2022	2023	2024
Grantet qeveritare	8,735,271.00	9,148,900.00	9,597,019.00
Totali i të H.Vetanake	2,920,809.00	3,027,583.00	3,151,620.00
Taksa për regjistrimin e automjeteve	110,000.00	120,000.00	125,000.00
Taksa Komunale për leje ndërtimi	1,190,000.00	1,210,000.00	1,223,000.00
Taksa për Regjistrimin e Trashëgimisë	35,000.00	40,000.00	40,000.00
Taksë Admini.(Certifik.lind.,kurorëzim., vdekjes,shtet., etj)	45,000.00	50,000.00	51,000.00
Taksa Administrative -Fletëkërkesat	25,000.00	28,000.00	30,000.00
Leje mjedisore Komunale	70,000.00	80,000.00	90,000.00
Taksa për ushtrimin e veprimtarisë -biznese	9,876.00	13,000.00	15,000.00
Licencimi i reklamave publike në pronën publike	2,000.00	3,000.00	3,000.00
Regjistrimi i pengut - hipoteka	20,000.00	25,000.00	26,000.00
Licencimet tjera - zgjatja e orarit të punës	1,000.00	2,005.00	3,000.00
Inspektimet (ushqimore, higjieniko - sanitare, veterinë, etj)	5,000.00	6,000.00	7,000.00
Të hyrat nga shërbimet e ndryshme (qiraja, etj.)	10,000.00	12,000.00	13,000.00
Të hyrat nga shër. e ndryshme (Kopja e pl., Parcelimi)	63,000.00	75,000.00	75,000.00
Të hyrat nga tatimi në pronë	1,032,423.00	1,074,647.00	1,123,498.00
Të hyrat nga tatimi në tokë	70,165.00	80,168.00	99,171.00
Të hyrat nga arsimi	110,000.00	120,000.00	123,804.00
Të hyrat nga shëndetësia	48,000.00	52,000.00	55,000.00
Të tjera -	75,345.00	36,763.00	49,147.00
TOTALI ;	11,656,080.00	12,176,483.00	12,748,639.00

5. Buxhetimi i programeve

Do të bëhet sipas programeve dhe nënprogrameve të Administratës, të Arsimit dhe të Shëndetësisë. Nga drejtorët do të kërkohet të përcaktojnë se në cilat programe do të bëhet shpërndarja e fondeve, si dhe shumën që do të vihet në dispozicion me buxhet për secilin program. Transferet në mes të programeve do të kufizohen gjatë vitit buxhetor 2021, ndërsa Drejtorët e Programeve do të jenë përgjegjës dhe të autorizuar për bërjen e shpenzimeve nga programet e tyre.

Buxhetet Komunale 2021 - 2023 do të përgatiten nëpër të gjitha kategoritë ekonomike për shpenzimet e buxhetuara, të definuara sipas Thesarit, e që janë: “Paga e mëditje”, “Mallra e shërbime”, “Shërbime komunale”, “Subvencione e transfere” dhe “Shpenzime kapitale”.

6.Struktura e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për komuna 2022-2024

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur struktura e shpenzimeve komunale për periudhën e ardhshme trevjeçare 2022-2024.

Tabela 4: Struktura e shpenzimeve për buxhetin komunal gjatë viteve 2020-2024

Përshkrimi	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Total Shpenzimi	579,742,721	546,801,281	567,529,451	595,696,678	624,741,164
Numri i punëtorëve	44,349	44,415	44,480	44,480	44,480
Paga dhe mëditje	308,147,000	278,388,425	282,707,782	284,121,321	285,541,928
Mallra dhe shërbime	75,742,746	79,976,834	87,976,834	90,900,000	92,000,000
Shpenzime	11,527,757	11,814,249	12,100,000	12,500,000	13,000,000
Subvencione dhe T.	13,490,858	15,942,585	19,924,835	21,500,000	23,000,000
Shpenzime kapitale	170,834,360	147,025,254	164,820,000	186,675,357	211,199,236
Rezerva		13,653,934			
Burimet	579,742,721	546,801,281	567,529,451	595,696,678	624,741,164
Grantet qeveritare	485,096,142	461,419,508	480,127,795	503,160,821	528,233,139
Të hyrat vetanake	83,116,579	78,000,000			
Financimet nga huamarrjet	11,530,000		87,401,656	92,535,857	96,508,025
Financimi nga Klauzola e investimeve -	11,530,000	7,381,773		-	-

7. Shfrytëzimi i Vlerësimeve të Hershme

Ky buxhet aktual nënkupton që kostoja e vlerësuar e programeve të vazhdueshme komunale do të publikohet për buxhetin në dy vitet vijuese (këto dy vite referohen si vlerësime të hershme). Edhe pse publikohet buxheti trevjeçar, vetëm fondet për vitin aktual buxhetor do të ndahen në bazë të parasë së gatshme, shih tabelën nr. 5,6,7.

Tabela 5. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2022

Kodet e Progra m.	Programet/ nën-programet	Stafi 2021	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	15	136,026.86	25,325.00		40,000.00		201,351.86
16302	Administrata e Personeli	20	133,694.99	55,000.00			-	188,694.99
16422	Regjistrimi civil	8	45,905.56	5,000.00				50,905.56
16502	Çështjet gjinore	2	15,732.69	9,500.00				25,232.69
16603	Inspektimet	13	86,969.35	20,000.00				106,969.35
16902	Zyra e Kuvendit		97,851.16	32,000.00				129,851.16
17502	Buxhet dhe Financa	11	79,994.42	20,500.00		30,000.00	550,593.00	681,087.42
18162	Shërbimet Publike	14	87,746.56	770,100.00	129,000.00		1,434,938.00	2,421,784.56
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	36,670.39	4,000.00				40,670.39
19710	Z.K.K	5	29,918.13	10,000.00				39,918.13
47042	Bujqësia	10	65,748.21	40,000.00		60,000.00		165,748.21
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	58,868.00	15,000.00				73,868.00
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	11	70,836.30	15,500.00				86,336.30
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	16	104,097.98	18,000.00			785,000.00	907,097.98
73011	Administr. e shëndetësisë	5	34,983.95	103,707.00	60,000.00	107,000.00	300,000.00	605,690.95
73150	Shërbimet e shëndetësisë primare	114	834,900.84	222,996.00				1,057,896.84
75506	Shërbimet Sociale	10	65,378.00	26,900.00	7,500.00			99,778.00
85002	K.R. dhe Sportet	15	83,966.97	77,000.00		35,000.00	450,000.00	645,966.97
92010	Administrata e Arsimit	6	41,889.16	50,000.00		115,000.00	360,000.00	566,889.16
92230	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	35	209,148.27	60,502.00	10,000.00			279,650.27
93030	Arsimi Fillor	412	2,363,399.86	190,173.00	40,300.00			2,593,872.86
94230	Arsimi i Mesëm	88	613,618.35	60,000.00	13,200.00			686,818.35
TOTALI		824	5,297,346.00	1,831,203.00	260,000.00	387,000.00	3,880,531.00	11,656,080.00

Tabela 6. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2023

Kodet e Progra m.	Programet/ nën- programet	Stafi 2022	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencion e e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	15	137,426.06	25,325.00		40,000.00		202,751.06
16302	Administrata e Personeli	20	154,764.99	55,000.00			-	209,764.99
16422	Regjistrimi civil	8	64,305.56	5,000.00				69,305.56
16502	Çështjet gjinore	2	18,532.69	9,500.00				28,032.69
16603	Inspektimet	13	87,965.35	20,000.00				107,965.35
16902	Zyra e Kuvendit		100,851.16	32,000.00				132,851.16
17502	Buxhet dhe Financa	11	83,994.42	20,500.00		30,000.00	619,954.00	754,448.42
18162	Shërbimet Publike	14	89,746.56	820,100.00	129,000.00		1,806,404.00	2,845,250.56
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	42,670.39	4,000.00				46,670.39
19710	Z.K.K	5	32,918.13	10,000.00				42,918.13
47042	Bujqësia	10	68,748.21	40,000.00		60,000.00		168,748.21
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	63,868.00	15,000.00				78,868.00
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	11	74,836.30	15,500.00				90,336.30
66015	Planifikimi urban dhe mjedisi	16	109,097.98	18,000.00			811,157.00	938,254.98
73011	Administr. e shëndetësisë	5	38,983.95	103,707.00	60,000.00	117,000.00	200,000.00	519,690.95
73150	Shërbimet e shëndetësisë primare	118	864,900.84	242,996.00				1,107,896.84
75506	Shërbimet Sociale	10	68,378.28	26,900.00	7,500.00			102,778.28
85002	K.R. dhe Sportet	15	85,966.97	77,000.00		35,000.00	400,000.00	597,966.97
92010	Administrata e Arsimit	6	43,889.16	63,947.52		125,000.00	222,366.00	455,202.68
92230	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	35	211,148.27	70,502.00	29,640.00			311,290.27
93030	Arsimi Fillor	427	2,384,399.86	230,173.00	60,300.00			2,674,872.86
94230	Arsimi i Mesëm	92	613,618.35	60,000.00	17,000.00			690,618.35
TOTALI		847	5,441,011.48	1,965,150.52	303,440.00	407,000.00	4,059,881.00	12,176,483.00

Tabela 7. Planifikimi i Buxhetit për vitin 2024

Kodet e Program.	Programet/ nën programet	Stafi 2023	Paga e Mëditje	Mallra e Shërbime	Shpenzime Komunale	Subvencione e Transfere	Investime Kapitale	Totali
16002	Zyra e Kryetarit	15	147,356.05	25,325.00		40,000.00		212,681.05
16302	Administrata e Personeli	20	164,635.00	58,000.00			-	222,635.00
16422	Regjistrimi civil	8	66,412.56	5,000.00				71,412.56
16502	Çështjet gjinore	2	19,732.69	10,000.00				29,732.69
16603	Inspektimet	13	89,165.00	22,000.00				111,165.00
16902	Zyra e Kuvendit		104,111.94	35,000.00				139,111.94
17502	Buxhet dhe Financa	11	85,194.42	22,500.00		30,000.00	553,970.48	691,664.90
18162	Shërbimet Publike	14	91,736.56	899,800.00	139,000.00		1,952,986.00	3,083,522.56
18210	Shërbimet e zjarrfikësve	5	45,421.42	5,000.00				50,421.42
19710	Z.K.K	5	36,399.15	11,000.00				47,399.15
47042	Bujqësia	10	69,548.29	45,000.00		60,000.00		174,548.29
48002	Zhvillimi Ekonomik	9	71,168.00	16,000.00				87,168.00
65010	Kadastra dhe Gjeodezia	11	79,856.30	16,500.00				96,356.30
66015	Planifikimi Urban dhe Mjedisi	16	115,197.98	22,000.00			846,537.00	983,734.98
73011	Administr. e shëndetësisë	5	39,923.95	109,997.00	60,000.00	117,000.00	311,850.16	638,771.11
73150	Shërbimet e shëndetësisë primare	118	910,936.64	252,196.00				1,163,132.64
75506	Shërbimet Sociale	10	71,478.28	29,860.00	7,500.00			108,838.28
85002	K.R. dhe Sportet	15	89,234.97	82,000.00		35,000.00	300,000.00	506,234.97
92010	Administrata e Arsimit	6	43,889.16	63,947.52		125,000.00	290,000.00	522,836.68
92230	Arsimi parashkollor dhe çerdhet	35	221,148.27	72,502.00	29,640.00			323,290.27
93030	Arsimi Fillor	427	2,512,689.86	220,173.00	70,300.00			2,803,162.86
94230	Arsimi i Mesëm	92	597,618.35	60,000.00	23,200.00			680,818.35
TOTALI		847	5,672,854.84	2,083,800.52	329,640.00	407,000.00	4,255,343.64	12,748,639.00

8. Programi i Investimeve (Kapitale) Publike – PIP

Në tabelën nr.8 janë paraparë investimet kapitale për periudhën 3 vjeçare. Këto propozime janë vlerësime të hershme të cilat mund të ndryshohen nga kërkesat e qytetarëve, brenda kufijve buxhetor. Nga drejtoritë do të kërkohej të përgatisin analizat e PIP për të gjitha projektet e investimeve publike. Propozimet që nuk përmbajnë analizat e PIP nuk do të merren parasysh për financim. Propozimet e PIP do të përfshijnë si ato për shqyrtim të financimit nga BKK dhe të Hyrat Vetanake ashtu edhe ato që propozohen për financim nga donatorët. Ato duhet të përfshijnë projekte që do të niseshin në vitet 2022, 2023 dhe 2024, jo vetëm projektet që fillojnë në vitin 2022.

Ne kërkojmë nga drejtorët e drejtorive që të fillojnë me përgatitjen e kërkesave të tyre për projektet kapitale, sa më herët që është e mundur, kjo do të ndihmonte në shmangien e vonesave pasuese! Propozimet e projekteve që janë dorëzuar në procesin e PIP vitin e kaluar, por që nuk janë financuar, mund të dorëzohen sërish.

Tabela 8. Programi Komunal i Investimeve Publike (PIP) 2022 – 2024

Nr.	Kod. Fun.	Ko. pr.	Emri i Projektit	Plani 2022 nga i cili:			Projeksi. 2023	Projeksi. 2024
				Kostoja totale	Transfere t qeveritare	Të hyrat vetanake		
I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX
			SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	3,880,531	1,346,772	2,533,809	4,053,724	4,255,344
			612175-Buxhet dhe Financa	550,593	350,593	200,000	619,954	553,970
1	0112		Bashkëfinancimi i projekteve të ndryshme sipas prioritetit të Komunës	350,593	350,593		369,954	210,097
2	0112		Pagesa për vendime gjyqësore	200,000		200,000	250,000	343,873
			612180-Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia	1,434,938	276,129	1,158,809	1,806,404	1,952,986
3	0451		Ndërtimi i rrugëve me zhavorr	80,809		80,809	144,629	104,322
4	0451		Ndërtimi i urave, shtratit të lumenjve, liqeneve, përroskave, etj.	36,129	36,129		70,000	60,080
5	0451		Rregullimi i parkut në pisha të Sllatinës së Vogël	30,000		30,000	100,000	50,000
6	0452		Mirëmbajtja Investive, (rregullimi i varrezave nëpër vendbanime, rrethoja, pastrim, përkufizime etj.)	120,000		120,000	100,000	200,000
7	0451		Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e tyre	120,000		120,000	100,000	300,000
8	0451		Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve.	80,000		80,000	120,000	50,000
9	0451		Blerja e Kontejnerëve, Komposterave.	30,000	-	30,000	120,000	150,000
10	0451		Rastet emergjente	110,000		110,000	46,000	140,000
11	0451		Ndërtimi i parqeve, trotuareve, këndi i lojërave dhe mbjellja e pemëve dekorative	138,000		138,000	98,913	250,000
12	0451		Vendosja e kamerave nëpër vendbanime	90,000	90,000		100,000	100,000
13	0451		Rregullimi i sheshit në Lagjen Dardania	300,000		300,00	616,862	200,000

14	0451		Ndërtimi i katit shtesë (2) të objektit të Komunës	300,000	150,000	150,000	-	-
15	0451		Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza	-			190,000	348,584
	612660-Planifikimi Urban dhe Mjedis			785,000	460,000	325,000	805,000	846,537
16	0620		Asfaltimi në Fushë-Kosovë	230,000	230,000		230,000	271,537
17	0620		Asfaltimi në Graboc	20,000	20,000		20,000	10,000
18	0620		Asfaltimi në Bardh të Madh	45,000	45,000		45,000	50,000
19	0620		Asfaltimi në Bardh të Vogël	15,000	15,000		10,000	10,000
20	0620		Asfaltimi në Sllatinë të Madhe	45,000	45,000		40,000	30,000
21	0620		Asfaltimi në Sllatinë të Vogël	20,000	20,000		10,000	10,000
22	0620		Asfaltimi në Vragoli	20,000	20,000		20,000	20,000
23	0620		Asfaltimi në Miradi të Epërme	15,000	15,000		30,000	35,000
24	0620		Asfaltimi në Nakaradë	20,000	20,000		25,000	20,000
25	0620		Asfaltimi në Harilaç	20,000	20,000		15,000	10,000
26	0620		Asfaltimi në Henc	25,000		25,000	15,000	10,000
27	0620		Asfaltimi në Lismir	20,000		20,000	20,000	20,000
28	0620		Asfaltimi në Kuzmin	10,000	10,000		20,000	10,000
29	0620		Asfaltimi në Pomozotin	15,000		15,000	20,000	20,000
30	0620		Asfaltimi në Miradi të Poshtme	25,000		25,000	25,000	20,000
31	0620		Hartimi i Planit të Mobilitetit dhe Projekteve ideore	100,000		100,000	100,000	100,000
32	0620		Ndërtimi i kanalizimeve dhe ujësjellësit (fshatra, qytet)	140,000		140,000	160,000	200,000
	612730-Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale			300,000	100,000	200,000	200,000	311,850
33	0760		Ndërtimi i shtëpive për raste sociale	100,000		100,000	100,000	201,026
34	0760		Renovimi i shtëpive për raste sociale	100,000		100,000	100,000	110,824
35	0760		Ndërtimi i QMF-së në Fushë-Kosovë(lagjja Italia)	100,000	100,000			
	612850 Kulturë, Rini dhe Sport			450,000		450,000	400,000	300,000
36	0820		Ndërtimi i sallave të sportit tek objektet shkollore	150,000		150,000	100,000	
37	0820		Palestra Sportive në Sllatinë të Vogël	300,000		300,000	300,000	300,000
	612920-Arsim dhe Shkencë			360,000	160,000	200,000	222,366	290,000
38	0980		Ndërtimi i Shkollës Filllore në Fushë-Kosovë	310,000	160,000	150,000		250,000
39	0980		Blerja e inventarit për shkolla	50,000		50,000	157,366	20,000
40	0980		Digjitalizimi në objektet shkollore dhe vendosja e kamerave				65,000	20,000

9. Fazat e procesit buxhetor 2022 - 2024

Pjesa në vijim prezanton kalendarin kohor të buxhetit komunal dhe ofron një përmbledhje të hapave dhe veprimeve që kërkohen gjatë procesit buxhetor komunal 2022 – 2024.

Hapi 1: Shqyrtimi i prioriteteve nga drejtoritë komunale

Ky hap kërkon nga drejtoritë që të bëjnë shqyrtimin e çështjeve rreth politikave dhe prioriteteve në fushat e tyre të përgjegjësisë. Në pajtim me prioritetet e gjera të komunës (kur janë në dispozicion) secila drejtori duhet të ofrojë gjithashtu listën përmbledhëse të propozimeve të politikave të reja me prioritet që do të propozohen për procesin buxhetor komunal 2022 - 2024 (d.m.th. që pritet të fillojnë për çdo vit), bashkë me opsionet për kursimet e mundshme në programet e prioritetit të ulët dhe me performancë të dobët.

Shqyrtimi i prioriteteve do t'iu mundësojë drejtorive që të garojnë në procesin e përcaktimit të prioriteteve në një fazë të hershme të procesit për zhvillimin e buxhetit dhe para se të merren vendimet për kufijtë e fortë buxhetor. Nëse propozimi apo opsioni aprovet (në parim) nga Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës, gjatë këtij procesi fillestar të shqyrtimit të prioriteteve, drejtoria do të bëjë kërkesën më të hollësishme, si pjesë e materialit buxhetor, në fazat e mëvonshme të procesit buxhetor.

Hapi 2: Dorëzimi i buxhetit

Dorëzimet e materialeve buxhetore janë mjete përmes të cilave drejtoritë bëjnë prezantimin e vlerësimeve të tyre buxhetore dhe propozimeve të hollësishme të politikave të reja si dhe opsioneve për kursime në kontekst të strategjisë afatmesme fiskale (dhe në pajtim me kufijtë fillestar buxhetor). Dorëzimi buxhetor duhet të dizajnohet për të thjeshtësuar mbledhjen e informatave dhe rrjedhën e punës së Komitetit për Politikë dhe Financa. Me shfrytëzimin e vlerësimeve të hershme, dhe duke njohur faktin që shumica e programeve komunale vazhdojnë nga një vit në tjetrin, në fokus të marrjes së vendimeve rreth buxhetit do të jenë propozimet për programet shpenzuese të reja dhe/apo plotësuese si dhe ato që u nënshtrohen kursimeve potenciale në kontekst të pozitës aktuale fiskale.

Hapi 3: Dëgjimet buxhetore

Kur të ketë kaluar afati kohor i specifikuar me Qarkoren Interne Buxhetore Komunale 1, 2, ZKF do të shqyrtojë buxhetet e propozuara që janë dorëzuar nga njësitë funksionale. Drejtoritë dhe sektorët do të mbajnë seanca dëgjimore me qëllim të shqyrtimit dhe të kuptuarit të buxheteve të propozuara, me qëllim të përpjekjes për zgjidhjen e çështjeve dhe shqetësimeve lidhur me buxhetet e propozuara, veçmas për sa i përket pajtueshmërisë së tyre me kufijtë fillestar specifik të departamenteve. Qytetarët do të

njoftohen me kohë rreth dëgjimeve buxhetore (dy javë para mbajtjes) përmes shtypit ditor, mediave elektronike dhe njoftimeve publike.

Koha e mbajtjes së dëgjimeve buxhetore:

Dëgjimet buxhetore me qytetarë mbahen në sallën e Kuvendit të Komunës:

- 1. Më 2 korrik 2021, ora 10,**
- 2. Më 23 korrik 2021, ora 10,**
- 3. Më 27 gusht 2021, ora 10.**

Hapi 4: Shqyrtimi i buxhetit komunal

Kur Kryetari, së bashku me drejtorët e drejtorive, të ketë aprovuar buxhetin e propozuar komunal për tri vitet e ardhshme fiskale, përfshirë këtu dhe dokumentet përcjellëse ashtu si kërkohet nga MEF, atëherë Kryetari bën dorëzimin e dokumenteve të buxhetit të propozuar në KPF dhe në Kuvendin e Komunës. Dokumentacioni Përmbledhës i Buxhetit për publikim, shpërndarje dhe shfrytëzim nga ana e Kuvendit të Komunës, dhe opinionit publik gjithashtu, do të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e detajuar të buxhetit. Kuvendi bën shqyrtimin e tyre në takimin e rregullt të radhës, apo në ndonjë takim special të ftuar më herët, me qëllim të shqyrtimit të atyre dokumenteve. Rekomandohet që Kuvendi i Komunës të organizojë takim të paralajmëruar në mënyrë adekuate, ku kërkohet nga opinioni publik, kontributi i tyre në lidhje me buxhetin, si dhe shqyrtimin dhe aprovimin e tij. Ky takim duhet të jetë i mbuluar nga mediat, buxheti publik të adresohet nga ZKF dhe Kryetari i Kuvendit të Komunës, ndërsa rekomandohet që të jetë ky një takim i hapur me publikun, në përputhje me Rregulloret.

10.Kalendari kohor

Organizatat buxhetore të nivelit lokal duhet t'i përmbahen këtij kalendari kohor në përgatitjen e propozim buxhetit:

- 30 qershor: Aprovimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale,
- 30 shtator: Aprovimi i propozim-buxhetit komunal për vitin 2022-2024 nga Kuvendi Komunal,
- 30 shtator: pas aprovimit të propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal, komunat janë të obliguara të dorëzojnë në Ministrinë e Financave dokumentet si në vijim:
- Shkresa përcjellëse bazuar në aprovimin e propozim-buxhetit nga Kuvendi Komunal (nënshkruar nga Kryetari i Komunës).

- Vendimi i Kuvendit Komunal mbi aprovimin e propozim-buxhetit komunal për vitin 2022-2024, përfshirë projektet kapitale shumëvjeçare.
- Tabelat e buxhetit komunal (SZHMB-se dhe PIP):
- Tabela 4.1 - plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve për vitin 2022-2024 (kopje e shtypur prej BDMS, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.2 - financimi i projekteve kapitale për vitin 2021 dhe projekteve kapitale shumëvjeçare për vitin 2022-2024 (shtypur nga sistemi PIP, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabela 4.3 - plani afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal nga grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake (shtypur nga SZHMB, vulosur si dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ZKF),
- Tabelat e Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinator.

Shef për Plan. B.
Ma. Bardhyl Koiçiçi

Drejtore i Drejtorisë
Ramadan Jashanica